



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më _____. _____. 2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Mallra , e hapur mbi kufirin e larte monetar

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti : Blerje mjete (makine asfalti, skrep, bobcat, autoshkalle), per Ndermarrjen e Sherbimeve Publike

Fondi limit : 25,966,667 (Njezete e pesemije e nenteqind e gjashtedhjetë e gjashtemije e gjashteqind e gjashtedhjetë e shtate) Leke pa TVSH

Fondi Limit : 276,594 (dyqind e shtatedhjetë e gjashtemije e peseqind e nentëdhjetë e kater) Euro, me kurs kembimi 93.88 sipas Bankes se Shqiperise date 03.07.2026

Kodi CPV: 34144211-0 - Autoshkalla, 43262100-8 - Eskavatorë mekanikë, 43312300-6 - Makineri asfaltimi,

Tipi i Proçedurës: E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra

REF-93064-07-09-2026

Bazuar ne Neni ne 56, te LPP 162/2020, si dhe nenet 12 dhe 24 te VKM per RPP Nr.285 date 19.05.2021, dokumentat e tenderit ne procedurat mbi Kufirin e Larte Monetar vlere e fondit Limit konvertohet ne nje monedhe nderkombetare sipas kursit te Bankes se Shqiperise. (Tek Njoftimi I shkurter qe eshte per tu Publikuar shqip dhe anglisht si dhe ne DST).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti / Enti Kontraktor, Bashkia Vlore, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *“Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”*.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik të ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit të lotit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme."

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur të thjeshtuar" edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për kestet e maturuara te vitit 2026 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, I ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.4 Operatori ekonomik pjesëmarres duhet të paraqesë Çertifikate **ISO 9001:2015** “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) **ose ekuivalent**; Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Secili nga dokumentat duhet të jetë i vlefshëm, nëse është në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer në shqip dhe i noterizuar, si dhe të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit ose distributorit të autorizuar si: tel, fax, email, website, etj., kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Autorizimi është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofruesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësor të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standartet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë

me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmerinë e OE ofrues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben AK për njohjen e mundësisë së OE- së për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të ligjit 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" dhe pikën 6, të nenit 40, të V.K.M Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge ose skeda teknike nga prodhuesi ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

2.7 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **deklaratë garancie në të cilën të jenë të përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi. Periudha e garancisë teknike do të fillojë nga data e marrjes në dorezim të mjetit nga autoriteti kontraktor dhe të jetë minimumi: 1 (nje) vit.**

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen të operatorit ekonomik kontraktues.

2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë licencë të vlefshme lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Kategoria VII.3.1 sipas Udhezimit Nr. 1545 datë 29.03.2016, "Blerje, shitje e mjeteve me motor dhe rimorkjo ose licence ekuivalente sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallit, objekt prokurimi.

2.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjetit të targuar**, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë (zhdoganimin, regjistrimin, targimin me targa shqiptare,etj

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Ky kriter është i nevojshëm pasi automjeti objekt prokurimi duhet të dorëzohet në gjendje të rregullt juridike dhe teknike, i pajisur me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë për të qenë i gatshëm për qarkullim dhe përdorim të menjëhershëm nga Ndërmarrja e Pastrimit.

Kërkesa për përfshirjen në çmim të procedurave të zhdoganimit, regjistrimit dhe targimit:

- garanton që Autoriteti Kontraktor të mos ketë kosto shtesë pas lidhjes së kontratës;
- siguron ekzekutim të plotë dhe funksional të kontratës;
- shmang vonesat administrative që do të pengonin vënien në përdorim të mjetit;
- garanton që mjeti të jetë në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknike për qarkullim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky kriter vlerësohet proporcional dhe i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, pasi lidhet me funksionalitetin dhe përdorimin efektiv të automjetit që do të vihet në shërbim të ndërmarrjes. Për më tepër, ai është në përputhje me parimet e eficiencës, efektivitetit dhe mirëadministrimit të fondeve publike, duke garantuar që Autoriteti Kontraktor të marrë në dorëzim një mjet plotësisht funksional dhe të gatshëm për përdorim.

2.10 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset për të garantuar që automjetet:

- janë në përputhje me standarde të njohura ndërkombëtarisht të cilësisë, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit;
- mund të regjistrohen dhe të përdoren pa pengesa, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- sigurojnë besueshmëri në funksionim, disponueshmëri të pjesëve të këmbimit dhe mundësi për mirëmbajtje sipas standardeve të prodhuesit;
- ulin kostot operative dhe ndikimin në mjedis gjatë gjithë ciklit të përdorimit të automjetit.

Kërkesa nuk lidhet domosdoshmerisht me vendin e prodhimit ose origjinën e automjetit, por vetëm me përmbushjen e standardeve teknike dhe dokumentimin e përputhshmërisë së tij. Për këtë arsye, ajo respekton parimet e trajtimit të barabartë, duke siguruar njëkohësisht që nevojat funksionale të Autoritetit Kontraktor të përmbushen me automjete që garantojnë cilësi, siguri dhe performancë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit jane të hartuara nga Grupi i Punës, në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shënim: Në çdo rast kur në specifikimet teknike mund të jetë e përdorur si referenece emri i ndonje marke apo emri te veçante, patente, vizatim ose tip ose origjine ose prodhim specifik, përfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR MJETIN MAKINERI ASFALTI

Fuqia e motorit minimum 9 kW është e domosdoshme për të siguruar funksionimin e pandërprerë të makinerisë gjatë shtrimit të asfaltit në punime të mirëmbajtjes. Kjo fuqi garanton, funksionimin e njëkohshëm të sistemit të lëvizjes, transportimit të materialit dhe tavolinës së shtrimit (screed),aftësinë për të punuar në pjerrësi dhe në kushte të ndryshme terreni.

Gjerësia e shtrimit minimum 300 mm dhe maksimumi minimum 1450 mm lejon përdorimin e makinerisë si në riparime të ngushta (gropa, kanale teknologjike), ashtu edhe në sipërfaqe më të gjera si trotuare, sheshe dhe rrugica. Gjerësia e rregullueshme rrit fleksibilitetin e përdorimit dhe shmang nevojën për pajisje shtesë.

Trashësia e rregullueshme deri në 100 mm është e nevojshme për të realizuar shtresa të ndryshme asfalti sipas projektit teknik, si në shtresat bazë ashtu edhe në ato përfundimtare, duke garantuar cilësinë dhe jetëgjatësinë e ndërhyrjeve.

Kapaciteti i kazanit minimum 0.7 m³ siguron furnizim të vazhdueshëm me asfalt gjatë procesit të shtrimit, duke reduktuar ndërprerjet për rimbushje dhe duke përmirësuar cilësinë e sipërfaqes së asfaltuar.

Shpejtësia e shtrimit min 25 m/min është i përshtatshëm për punime të mirëmbajtjes urbane dhe garanton përfundimin e ndërhyrjeve brenda afateve operative, duke optimizuar përdorimin e burimeve njerëzore dhe makinerive.

Tavolina e shtrimit (Screed) me ngrohje parandalon ngjitjen e asfaltit në sipërfaqen e screed-it, siguron shpërndarje dhe nivelim uniform të materialit asfaltik dhe ruan temperaturën optimale të asfaltit në momentin e shtrimit

Gjatësia maksimale 3 200 mm vendoset për të garantuar manovrueshmërinë në rrugë urbane, rrugica të ngushta, trotuare dhe ambiente me hapësira të kufizuara. Një makineri me përmasa më të mëdha do të kishte vështirësi në lëvizje, transport dhe pozicionim gjatë punimeve të mirëmbajtjes, duke ulur efikasitetin operacional.

Gjerësia maksimale 1 300 mm është e nevojshme për të siguruar që makineria të mund të kalojë dhe të punojë në zona me kufizime hapësinore, si rrugë të ngushta, trotuare, korsitë e biçikletave dhe zona të banuara. Gjithashtu, kjo përmasë lehtëson transportin pa nevojën për masa të veçanta transporti.

Lartësia maksimale 1 500 mm synon të garantojë transport të sigurt, magazinim më të lehtë dhe një qendër graviteti më të ulët, e cila përmirëson stabilitetin e makinerisë gjatë punës. Gjithashtu,

kjo përmasë lejon përdorimin e makinerisë në ambiente me kufizime në lartësi, si nën ura, në parkingje ose zona të mbuluara.

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR MJETIN AUTOSHKALLË

Kërkesa për motor me fuqi minimale **130 HP** është e domosdoshme për të garantuar lëvizjen e sigurt të automjetit së bashku me platformën ajrore, sistemin hidraulik, stabilizatorët dhe pajisjet ndihmëse. Kjo fuqi siguron performancë të mjaftueshme gjatë qarkullimit në terrene me pjerrësi, në rrugë urbane dhe rurale, si dhe gjatë operimit të platformës në kushte ngarkese maksimale. Një fuqi më e ulët mund të ndikojë negativisht në funksionimin e sistemit hidraulik dhe në sigurinë gjatë punës.

Kërkesa për standardin **EURO VI** garanton që automjeti të përmbushë standardet më të fundit për emetimet e gazrave ndotës, duke reduktuar ndikimin në mjedis, konsumin e karburantit dhe kostot operative. Gjithashtu siguron pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi dhe mundëson përdorimin e automjetit pa kufizime në zonat urbane.

Kabina me kapacitet minimal për **2 persona** është e nevojshme për transportin e operatorit të platformës dhe një punonjësi ndihmës ose specialisti, duke shmangur nevojën për një automjet të dytë dhe duke rritur efikasitetin operacional.

Lejimi i të dy varianteve të kambios shmang kufizimin e konkurrencës dhe u jep operatorëve ekonomikë mundësinë të ofrojnë automjete që përmbushin kërkesat funksionale pa favorizuar një teknologji të caktuar.

Kufizimi i gjatësisë maksimale në **6000 mm** është i nevojshëm për të garantuar manovrueshmëri në rrugët urbane, rrugicat e ngushta dhe zonat me hapësira të kufizuara. Gjithashtu lehtëson parkimin, transportin dhe pozicionimin e automjetit në vendin e punës.

Gjerësia maksimale prej **2100 mm** mundëson qarkullimin normal në rrugët publike, hyrjen në zona të ngushta dhe ul rrezikun e dëmtimit të infrastrukturës ekzistuese gjatë manovrimit.

Lartësia maksimale garanton transport të sigurt nën ura, në tunele, nën linja elektrike dhe në ambiente me kufizime të lartësisë, duke rritur fleksibilitetin e përdorimit.

Xhama elektrikë, radio, kondicioner (AC) dhe mbyllje qendrore. Këto pajisje rrisin sigurinë, ergonominë dhe komoditetin e operatorit gjatë përdorimit të përditshëm, sidomos në kushte pune me temperatura të larta ose të ulëta dhe gjatë lëvizjes në distanca të gjata.

Krahu teleskopik siguron shtrirje më të madhe horizontale dhe vertikale pa pasur nevojë për zhvendosje të vazhdueshme të automjetit, duke rritur produktivitetin dhe sigurinë gjatë punës.

Shtrirja horizontale minimale prej **15.5 m** lejon kryerjen e punimeve në zona ku automjeti nuk mund të pozicionohet drejtpërdrejt poshtë objektit, si mbi trotuare, gardhe, gjelbërim ose pengesa të tjera.

Lartësia minimale prej **22 m** është e nevojshme për ndërhyrje në shtylla ndriçimi, pemë të larta, fasada ndërtesash, semaforë dhe rrjete ajrore, duke mbuluar shumicën e nevojave operative të autoritetit kontraktor.

Kapaciteti minimal **200 kg** garanton transportin e sigurt të operatorit, një punonjësi të dytë kur është e nevojshme, si dhe të veglave dhe materialeve të punës, pa tejkaluar kufijtë e projektimit të platformës.

Rrotullimi i platformës 360° mundëson pozicionimin optimal të operatorit ndaj objektit të punës pa lëvizur automjetin, duke ulur kohën e ndërhyrjes dhe rritur sigurinë.

Rrotullimi i kolonës 360° i vazhdueshëm eliminon kufizimet mekanike të lëvizjes dhe rrit ndjeshëm fleksibilitetin gjatë operimit në ambiente komplekse.

Platforma prej alumini kombinon peshën e ulët me rezistencën e lartë mekanike dhe ndaj korrozionit, duke rritur jetëgjatësinë e pajisjes dhe duke ulur nevojën për mirëmbajtje. Sistemi hidraulik me kontroll nga platforma dhe toka garanton fleksibilitet maksimal operimi dhe mundëson ndërhyrje të menjëhershme nga personeli në tokë në rast emergjence ose mosfunksionimi.

Nivelimi automatik siguron stabilitetin e platformës edhe në terrene me pjerrësi ose parregullsi, duke reduktuar rrezikun e aksidenteve dhe duke garantuar funksionimin korrekt të pajisjes. Telekomanda pa kablllo mundëson kontroll të platformës nga një distancë e sigurt gjatë pozicionimit fillestar, testimeve dhe situatave ku operatori nuk ndodhet në platformë. Pompa emergjente është element sigurie që mundëson uljen e platformës në mënyrë të kontrolluar në rast të fikjes së motorit ose avarisë së sistemit hidraulik, duke shmangur rrezikimin e personave në lartësi.

Katër stabilizatorë sigurojnë shpërndarje të barabartë të ngarkesës dhe stabilitet maksimal të automjetit gjatë punës në lartësi, pavarësisht kushteve të terrenit.

Kontrolli i pavarur i secilit stabilizator mundëson nivelimin e automjetit në terrene të pabarabarta dhe rrit sigurinë operative.

Aktivizimi pneumatik i PTO-së garanton angazhim të shpejtë, të sigurt dhe të besueshëm të pompës hidraulike, duke reduktuar konsumimin mekanik dhe rrezikun e aktivizimit të paqëllimshëm.

Prania e të paktën **3 butonave STOP** (në platformë, në bazë dhe në kabinë ose pozicione të tjera strategjike) mundëson ndërprerjen e menjëhershme të funksionimit në rast rreziku, duke rritur nivelin e sigurisë së operatorëve dhe personave përreth.

Kontrolli i ndezjes dhe fikjes së motorit nga platforma eliminon nevojën që operatori të zbresë për të ndezur ose fikur motorin gjatë punës, duke rritur efikasitetin dhe duke reduktuar ekspozimin ndaj rreziqeve.

Manuali teknik është i domosdoshëm për përdorimin, mirëmbajtjen dhe diagnostikimin korrekt të pajisjes, si dhe për trajnimin e operatorëve dhe respektimin e kërkesave të sigurisë.

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR MJETIN MINI NGARKUES ME GOMA

Kërkesa për vit prodhimi minimum 2026 garanton furnizimin me pajisje të teknologjisë së fundit, të pajisura me sistemet më moderne të sigurisë, efikasitetit dhe kontrollit elektronik. Gjithashtu siguron jetëgjatësi më të madhe operative, disponueshmëri të pjesëve të këmbimit dhe ulje të kostove të mirëmbajtjes gjatë viteve të para të përdorimit.

Makineria duhet të jetë e re dhe e papërdorur për të garantuar funksionim të plotë sipas parametrave të projektimit, jetëgjatësi maksimale dhe eliminimin e rrezikut të defekteve që lidhen me konsumimin nga përdorimi i mëparshëm.

Motori me naftë siguron çift rrotullues më të lartë në shpejtësi të ulëta, konsum më ekonomik dhe përshtatshmëri për punë intensive në kushte të vështira pune. Gjithashtu garanton autonomi më të madhe gjatë operimit.

Fuqia minimale 40 kW është e nevojshme për të garantuar performancën e makinerisë gjatë ngarkimit të materialeve, përdorimit të aksesorëve hidraulikë dhe lëvizjes në terrene me pjerrësi ose sipërfaqe të vështira. Kjo fuqi siguron produktivitet të lartë pa mbingarkuar motorin dhe garanton funksionim të njëkohshëm të sistemit të lëvizjes dhe atij hidraulik.

Pesha minimale prej 3500 kg është e domosdoshme për të garantuar stabilitetin e makinerisë gjatë ngritjes dhe transportimit të ngarkesave, duke reduktuar rrezikun e humbjes së ekuilibrit ose përmbysjes gjatë operimit.

Ngarkesa e përmbysjes (Tipping Load) – Minimum 2000 kg garanton që makineria të ketë rezervë të mjaftueshme stabiliteti gjatë ngritjes së materialeve. Një ngarkesë përmbysjeje prej të paktën 2000 kg siguron funksionim të sigurt edhe në kushte pune intensive dhe është tregues i drejtpërdrejtë i stabilitetit të makinerisë.

Kapaciteti operativ minimal prej 800 kg mundëson transportin dhe ngarkimin e materialeve si dhe përdorimin e aksesorëve të ndryshëm pa tejkaluar kufijtë e sigurisë së prodhuesit. Ky parametër është i përshtatshëm për shumicën e punimeve komunale dhe të mirëmbajtjes. Kapaciteti minimal 85 litra/minutë është i nevojshëm për të siguruar funksionimin efikas të sistemit hidraulik dhe të pajisjeve shtesë si fshesa mekanike, freza asfalti, çekiç hidraulik, auger, kapëse paletash, kositëse dhe pajisje të tjera. Një pompë me kapacitet më të ulët do të kufizonte përdorimin e aksesorëve dhe do të ulte produktivitetin.

Transmisioni hidrostatik siguron kontroll të saktë të shpejtësisë dhe drejtimit, manovrim të lehtë në hapësira të kufizuara, konsum më të ulët të komponentëve mekanikë dhe produktivitet më të lartë gjatë punës.

Komandimi elektronik me joystick mundëson kontroll më të saktë të lëvizjeve të krahëve dhe kovës, redukton lodhjen e operatorit dhe rrit sigurinë gjatë punës. Përdorimi i formulimit "ose ekuivalent" shmanj favorizimin e një teknologjie apo prodhuesi të caktuar.

Kova standarde është e përshtatshme për ngarkimin dhe transportin e materialeve të ndryshme si dhe për punimet e përditshme të autoritetit kontraktor. Ajo garanton fleksibilitet maksimal dhe mund të zëvendësohet me aksesorë të tjerë sipas nevojës.

Kufizimi i gjatësisë maksimale në 3000 mm është i nevojshëm për të garantuar manovrueshmërinë në rrugë të ngushta, trotuare, ambiente urbane dhe zona me akses të kufizuar. Gjithashtu lehtëson transportin dhe magazinimin e pajisjes.

Lartësia maksimale prej 2000 mm mundëson hyrjen e makinerisë në magazina, garazhe, ambiente të mbuluara dhe nën struktura me kufizime të lartësisë, duke rritur fleksibilitetin operacional.

Gjerësia maksimale prej 1700 mm garanton përdorimin e makinerisë në trotuare, rrugica dhe ambiente urbane me hapësira të kufizuara, pa penguar qarkullimin ose dëmtuar infrastrukturën përreth.

Kabina e mbyllur mbrohet operatorin nga pluhuri, reshjet, temperaturat ekstreme dhe zhurma, duke përmirësuar kushtet e punës, sigurinë dhe produktivitetin gjatë gjithë vitit.

Sedilja me pezullim redukton transmetimin e vibrimeve të operatorit gjatë punës në terrene të pabarabarta, duke ulur lodhjen fizike dhe rrezikun e dëmtimeve profesionale.

Ndriçimi i integruar është i domosdoshëm për punë në kushte me ndriçim të kufizuar, në orët e mbrëmjes ose në ambiente të mbyllura, duke garantuar siguri dhe cilësi të punës.

Alarmi akustik gjatë ecjes mbrapa është një element i rëndësishëm sigurie që paralajmëron personat pranë makinerisë dhe redukton rrezikun e aksidenteve në kantier.

Dritat e punës sigurojnë ndriçim të mjaftueshëm të zonës së operimit, duke rritur saktësinë e manovrave dhe sigurinë gjatë punës në kushte të errësirës ose motit të pafavorshëm.

Paneli elektronik i monitorimit lejon kontrollin në kohë reale të parametrave kryesorë të makinerisë, si temperatura e motorit, presioni i vajit, niveli i karburantit, orët e punës,

sinjalizimet e defekteve dhe intervalet e mirëmbajtjes. Kjo ndihmon në parandalimin e avarive, planifikimin e mirëmbajtjes dhe uljen e kostove operative.

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR MJETIN SKREP ME KOVË PARA DHE PAS

Kërkesa për vit prodhimi minimum 2025 synon furnizimin me një makineri të teknologjisë bashkëkohore, me komponentë të rinj, efikasitet më të lartë operacional dhe sisteme moderne të sigurisë. Kjo rrit jetëgjatësinë e pajisjes, ul frekuencën e defekteve dhe garanton disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të gjatë.

Makineria duhet të jetë e re dhe e përdorur për të garantuar performancën sipas parametrave të projektimit, funksionim të sigurt dhe eliminimin e rrezikut që lidhet me konsumimin ose historikun e panjohur të përdorimit.

Motori me naftë siguron çift rrotullues të lartë në rrotullime të ulëta, konsum ekonomik të karburantit dhe performancë të qëndrueshme gjatë punimeve të rënda të gërmimit dhe ngarkimit. Fuqia minimale 70 kW është e nevojshme për të garantuar funksionimin e njëkohshëm të sistemit të lëvizjes, pompës hidraulike dhe pajisjeve të punës pa humbje performance. Kjo fuqi mundëson kryerjen me efikasitet të punimeve të gërmimit, ngarkimit dhe transportit të materialeve edhe në terrene të vështira.

Kërkesa për standardin EURO V siguron reduktimin e emetimeve ndotëse, uljen e konsumit të karburantit dhe përputhshmërinë me kërkesat mjedisore në fuqi. Gjithashtu garanton përdorimin e teknologjive moderne të motorit.

Sistemi 4×4 është i domosdoshëm për të garantuar tërheqje dhe stabilitet maksimal gjatë punës në terrene të buta, me baltë, pjerrësi ose sipërfaqe të pabarabarta. Ky sistem rrit sigurinë dhe efikasitetin operacional në çdo kusht pune.

Pesha operative – Minimum 7800 kg siguron stabilitet të lartë gjatë gërmimit dhe ngritjes së ngarkesave, duke reduktuar rrezikun e humbjes së ekuilibrit dhe duke përmirësuar forcën e depërtimit të kovës në terren.

Gjerësia totale – Jo më shumë se 2 400 mm garanton që makineria të mund të operojë në rrugë urbane, rrugica dhe zona me hapësira të kufizuara, pa penguar qarkullimin dhe pa dëmtuar infrastrukturën ekzistuese.

Lartësia totale – Jo më shumë se 2 800 mm lehtëson transportin e makinerisë, hyrjen në ambiente të mbuluara dhe kalimin nën ura apo struktura me kufizime në lartësi.

Krahu teleskopik rrit ndjeshëm fleksibilitetin e punës, duke mundësuar gërmime në distanca dhe thellësi më të mëdha pa lëvizur makinerinë. Kjo ul kohën e punës dhe rrit produktivitetin në kantier.

Kapaciteti minimal prej 1 m³ siguron ngarkimin dhe transportin efikas të materialeve inerte, dheut, zhavorrit dhe mbetjeve, duke reduktuar numrin e cikleve të punës dhe kohën e përfundimit të operacioneve. Kova me funksion hapje/mbyllje rrit shumëfunksionalitetin e makinerisë, pasi mund të përdoret për ngarkim, kapje materiale, nivelim dhe punime të tjera pa nevojën për pajisje shtesë.

Lartësia e shkarkimit në pikën maksimale Minimum 2.75 m garanton shkarkimin e materialeve në kamionë dhe mjete transporti të përdorura zakonisht nga autoriteti kontraktor, pa kufizime operative.

Forca thyese e kovës së ngarkimit Minimum 7700 kgf garanton depërtimin efikas në materiale të ngjeshura, zhavorr, tokë argjilore dhe materiale të tjera të forta, duke rritur produktivitetin dhe duke reduktuar kohën e punës.

Kova e gërmimit Minimum 0.17 m³ është i përshtatshëm për hapjen e kanaleve, gërmimet për rrjete infrastrukturore, themele dhe punime të tjera komunale, duke ofruar balancë ndërmjet produktivitetit dhe saktësisë së punës.

Thellësia minimale prej 4.7 m mundëson realizimin e shumicës së punimeve për rrjete ujësjellësi, kanalizime, drenazhime dhe infrastrukturë nëntokësore, pa nevojën për pajisje shtesë.

Hapja e krahut në nivelin e tokës Minimum 5 500 mm lejon gërmimin në distancë nga makineria, duke reduktuar numrin e zhvendosjeve dhe duke rritur efikasitetin në kantier.

Forca thyese e kovës së gërmimit – Minimum 5 700 kgf garanton aftësi të lartë për gërmim në terrene të forta dhe materiale të ngjeshura, duke përmirësuar produktivitetin dhe ulur konsumin e kohës.

Presioni minimal prej 240 bar është i nevojshëm për të siguruar forcën dhe shpejtësinë e nevojshme të sistemit hidraulik gjatë operimit të krahut, kovës dhe pajisjeve ndihmëse.

Gjithashtu garanton performancë të qëndrueshme gjatë përdorimit intensiv.

Prania e linjës hidraulike mundëson përdorimin e çekiçit hidraulik dhe aksesorëve të tjerë pa modifikime shtesë në makineri, duke rritur fleksibilitetin dhe ulur kostot e ardhshme të përshtatjes.

Komandimi me joystick mundëson kontroll më të saktë të lëvizjeve hidraulike, rrit komoditetin e operatorit dhe redukton lodhjen gjatë punës intensive.

Sistem AC, radio, ekran LCD dhe port US përmirësojnë kushtet e punës së operatorit, mundësojnë monitorimin e parametrave të makinerisë dhe rrisin produktivitetin gjatë përdorimit të përditshëm.

Seti bazë i veglave është i nevojshëm për mirëmbajtjen rutinë dhe ndërhyrjet e shpejta teknike, duke reduktuar kohën e ndërprerjes së punës dhe duke siguruar funksionim të vazhdueshëm të pajisjes.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT

Jetmira HANAJ

Denis Agaraj

Laura Aliaj